



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 161, Datë 09.07.2018

PËR MIRATIMIN E “RREGULLORES MBI KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME GAZ NATYROR PËR KLIENTËT FUNDORË”.

Në mbështetje të Ligjit 102 /2015 “Mbi Sektorin e Gazit Natyror” nenit 16, pika 10; nenit 17, pika 1, gërma ç; nenit 75 si dhe në zbatim të neneve 15 dhe 26 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE, Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 09.07.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, për miratimin e rregullores “Për kushtet e përgjithshme, në shërbimin e furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë”,

Konstatoi se:

1. Neni 16, i Ligjit 102/2015” Për Sektorin e Gazit Natyror” në pikën 10 të tij përcakton si përgjegjësi të ERE-s, “miratimin e kushteve të përgjithshme të furnizimit, duke përfshirë këtu edhe hartimin në mënyrë transparente të të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale të përgjithshme.
2. ERE në Vendimin e Bordit Nr. 206, date 18.12.2017 vendosi: Fillimin e procedurave për miratimin e “Rregullores mbi Kushtet e Përgjithshme të Shërbimit të Furnizimit me Gaz Natyror për Klientët Fundorë”.
3. ERE në shkresat me Nr.809 Prot, datë 21.12.2017 dhe nr. 100/64 Prot, date 18.12.2017 ka bërë njoftimin në median e shkruar dhe i ka dërguar të gjitha palëve të treta dhe grupeve të interesit, draftine “Rregullores mbi Kushtet e Përgjithshme të Shërbimit të Furnizimit me Gaz Natyror për Klientët Fundorë” për tu konsultuar dhe për të paraqitur opinionet dhe komentet e tyre, me qëllim përmirësimin e draftit, në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe në respekt të mbrojtjes së të drejtave të klientëve të Gazit Natyror.
4. Në përfundim të afatit 15 ditor të përcaktuar në nenin 26, pika 6 të “Rregullores së Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, të miratuar me Vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, dhe deri më tani, nuk rezultoi te jete paraqitur ndonjë koment apo sugjerim nga asnjë palë e tretë apo grup interesi.

5. ERE gjithashtu në referencë të nenit 16, pika 25 e Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” e ka konsultuar këtë Draft Rregullore dhe me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë.
6. Në shkresën me nr. Nr.408 Prot Hyres, datë 23.05.2018 Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (ENC) ka paraqitur komentet dhe sygjerimet lidhur me këtë draft rregullore, të cilat janë marrë në konsideratë nga grupi i punës, duke u mbështetur edhe në praktika të tjera të rregulloreve të ngjashme.
7. Komentet dhe ndërhyrjet e EnC kanë të bëjnë me sigurimin e plotë dhe të duhur, në përputhje me Direktivën 2009/73/EC si dhe me Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit natyror”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë “Rregulloren për kushtet e përgjithshme në shërbimin e furnizimit me Gaz Natyror për Klientët Fundorë”.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, do të njoftoje të gjitha palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pa botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike, nga botimi në Fletoren Zyrtare.

https://ere.gov.al/doc/RREGULLAT_MBI_KUSHTET_E_PERGJITHSHME_TE_SHERBIMIT_TE_FURNIZIMIT_ME_GAZ_NATYROR__PER_KLIENTET_FUNDOR.pdf